



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

---

Numri i lëndës: 2019:295531  
Datë: 20.11.2023  
Numri i dokumentit: 04940498

**C.nr. 1603/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, me gjyqtari Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Xh.M, dhe S.M, që të dy nga Peja, të cilët i përfaqëson avokat B.A, nga Peja, sipas autorizimit kundër të paditurës K.P, të cilën e përfaqëson avokat D.S.G, nga Peja, sipas autorizimit, me bazë juridike kompensim i dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publike, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 20.11.2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR** kërkesëpadia e paditësve Xh.M, dhe S.M, nga Peja, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura K.P që paditësve në emër të zhdëmtimit- kompensimit të dëmit si pasojë e lëndimeve trupore të shkaktuara nga kafshimi i qenit endacak me datë 11.10.2023, tua paguajë shumat e të hollave, për paditësin Xh.M, dëmi jomaterial në emër të dhimbjeve fizike trupore shumë prej 2,000 euro, në emër të frikës për të gjitha llojet shumë prej 1,800 euro, në emër të dëmit material për shpenzime për ushqimin e përforcuar shumë prej 300 euro, për ndihmë nga personi i huaj shumë prej 300 euro, gjithsej shuma prej 4,400 euro, për paditësen S.M dëmi jomaterial në emër të dhimbjeve fizike trupore shumë prej 2,000 euro, në emër të frikës për të gjitha llojet shumë prej 1,800 euro, në emër të dëmit material për shpenzime për ushqimin e përforcuar shumë prej 300 euro, për ndihmë nga personi i huaj shumë prej 300 euro, për shëmtim shumë prej 600 euro, gjithsej shuma prej 5,000 euro, si dhe të DETYROHET e paditura K.P që paditësve tua paguaj shumë e përgjithshme prej 9400 euro, me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,454.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## Ar sy e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datë 23.12.2019, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi, kundër të paditurës për kompensimin e dëmit material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e kafshimit të qenit endacak me datë 11.10.2019. I autorizuari i paditësve në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar gjendja faktike e paraqitur në padi, po ashtu është vërtetuar në tërësi padia si nga baza ashtu edhe nga lartësia. Nga gjendja e vërtetuar faktike është vërtetuar se e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit material dhe jo material paditëses si pasojë e sulmit të kafshës (qenit) endacak pasi që sipas nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili ka përcaktuar se “komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë”, ndërsa par.1, pika e) “mbrojtjen e mjedisit lokal” dhe pika i) “promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”, andaj në bazë të kësaj dispozite e paditura K.P, ka legjitimitet pasiv dhe e njëjta është obliguar që t’iu ofroj siguri, të siguroj integritetin trupor dhe pasurinë e qytetarëve dhe njëkohësisht ti kompensoj të njëjtit në rast të sulmit të kafshëve (qenve) endacak. Detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit material dhe jo material këtu paditëses rrjedh nga neni 154 të LMD-së, ku është përcaktuar se “dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato kanë qenë shkak i dëmit”. Me ekzaminimin e drejtpërdrejtë të bërë në seancë paditësin deklaruan se të njëjtit kanë pësuar kafshim nga qentë endacak, ndërsa nuk ka qenë kontestues kafshimi i tyre. Po ashtu me ekspertizën e dt. 03.06.2023, të ekspertëve Mr.Sci.Dr.Vjollca Bince, Mr.Sci.Dr.Gani Jashanica, Dr. Shabn A.Mecinaj, dhe Dr. Flora Shunjaku, është vërtetuar lartësia e kërkesëpadsisë. Andaj nga gjykata ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Pejës që paditësve në emër të zhdëmtimit- kompensimit të dëmit si pasojë e lëndimeve trupore të shkaktuara nga kafshimi i qenit endacak me datë 11.10.2023, tua paguajë shumat e të hollave, për paditësin Xh.M, dëmi jomaterial në emër të dhimbjeve fizike trupore shumë prej 2,000 euro, në emër të frikës për të gjitha llojet shumë prej 1,800 euro, në emër të dëmit material për shpenzime për ushqimin e përforcuar shumë prej 300 euro, për ndihmë nga personi i huaj shumë prej 300 euro, gjithsej shuma prej 4,400 euro, për paditësen S.M dëmi jomaterial në emër të dhimbjeve fizike trupore shumë prej 2,000 euro, në emër të frikës për të gjitha llojet shumë prej 1,800 euro, në emër të dëmit material për shpenzime për ushqimin e përforcuar shumë prej 300 euro, për ndihmë nga personi i huaj shumë prej 300 euro, për shëmtim shumë prej 600 euro, gjithsej shuma prej 5,000 euro, si dhe të DETYROHET e paditura K.P që paditësve tua paguaj shumë e përgjithshme prej 9400 euro, me kamatë ligjore prej 8% të llogaritur nga data e ushtrimit të padsisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,454.00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar te specifikuar në shumë prej 1,454.60 euro.

Pala e paditur përmes të autorizuarës së saj, me përgjigje në padi të dorëzuar në gjykatë me datë 06.11.2023, ka deklaruar se palës së paditur i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë. Mbi bazën e dispozitave ligjore, kompetente për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, posaçërisht qenve endacak është Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë së Republikës së Kosovës. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësit me asnjë provë nuk i kanë argumentuar pretendimet e tyre, respektivisht gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se paditësit janë kafshuar konkretisht nga qeni endacak, pra në asnjë rrethanë nuk është vërtetuar se nga çfarë qeni janë kafshuar sepse kafshimi i kafshës/qenit nuk nënkupton domosdo se është qeni endacak por mund të jetë edhe kafshë/qen shtëpiak me pronarë personin e tretë, apo kafshë që ka ikur nga pronari/zotëruesi. Nga të lartcekurat nuk mund të prezumohet kauzaliteti e as të përcaktohet çfarëdo përgjegjësie me faj apo pavarësisht fajit (objektive) dhe as lidhja shkakësore mes “dëmit” dhe veprimit të paditurit. Andaj gjykatës i propozon që ta refuzon kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka bërë administrimin e këtyre provave: letërnjoftimi kopje për paditësin Xh.M, raporti nga konsulta për Xh.M i dt.22.10.2019, libreza e imunizimit, për Xh.M, diagnoza për Xh.M, lëshuar nga Dr.Lumturije Berisha, letërnjoftimi kopje për S.M, raporti nga konsulta për S. M, e dt.23.10.2019, libreza e imunizimit për S.M, udhëzimi për dhënien e terapisë me nr.018733, për S.M, diagnoza nga dr.Safete Muhaxheri e dt.11.10.2019, ekspertiza e përpiluar nga grupi i ekspertëve.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që ka gjetur se duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, kontestues ishte fakti i bazës së kërkesëpadiës, ku pala e paditur që nga fillimi e ka kontestuar padinë sa i përket fillimisht legjitimitetit pasiv të paditurës, më pastaj duke kontestuar faktin nëse paditësit janë kafshuar nga qeni endacak, si dhe nëse paditësit lëndimet e pësuar nuk i kanë marrë fare nga qeni endacak.

Nga Raporti nga konsulta i QMF në Pejë i lëshuar me dt. 22.10.2019 me Nr.regjistri 5090, dhe libreza e imunizimit, gjykata vërtetoi faktin se pala paditëse Xh.M, me datën 11.10.2019, ka marrë tretman në Qendrën e Mjekësisë Familjare, e cila është dita të cilën paditësi pretendon se është kafshuar nga qeni endacak.

Nga Raporti nga konsulta i QMF V, në Pejë i lëshuar me dt. 23.10.2019, he libreza e imunizimit, gjykata vërtetoi faktin se pala paditëse S.M, me datën 11.10.2019, ka marrë tretman në Qendrën e Mjekësisë Familjare V, e cila është dita të cilën paditësja pretendon se është kafshuar nga qeni endacak.

Këtyre provave materiale të mësipërme, gjykata ua ka falur besimin në tërësi, pasi që përmes të njëjtave vërtetohet fakti se palët paditëse kanë marrë tretman mjekësor lidhur me rastin që iu kishte ndodhur, e të cilat prova paraqesin gjendjen shëndetësore në aspektin fizik të palëve paditëse.

Si provë materiale, është administruar dhe ekspertiza mjekësore e përpiluar nga grupi i ekspertëve Mr.Sci.Dr. Vjollca Bince-ortoped traumatolog, Mr.Sci.Dr.Gani Jashanica –ortoped tramuatolog, Dr. Shaban A.Mecinaj-psikiater, dhe Dr. Flora Shunjaku-psikiater, me dt. **10.12.2021**, përmes së cilës të njëjtit duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor nga shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve me dt. **03.06.2022**, kanë konstatuar se paditësja S.M, si pasojë e kafshimit nga qeni me dt. 11.10.2019, ka pësuar këto lëndime trupore: plagë shqyese në regjionin e pasëm të kërcirit të majtë, lëndimet karakterizohen si lëndime të lehta trupore, dhembjet fizike: - me intensitet posaçërisht te 5 minuta, duke përfshirë kohën nga kafshimi i qenit e deri në marrjen e ndihmës se parë në QKMF Pejë. - Me intensitet të rëndë 1 ditë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë se ordinuar kundër dhimbjes për shkak të dhimbjes në pjesën e pasme të kërcirit të majtë si pasojë e plagës nga kafshimi i qenit.- Me intensitet të mesëm 7 ditë, koha e nevojshme për tërheqjen e hematomeve, inflamacioneve post tramuatike nën veprimin e terapisë, si dhe koha e nevojshme për mbylljen e plagës. – Me Intensitet të ulët intenzivisht edhe për 15 ditë tjera të shprehur me dhimbje të përhershme në pjesën e pasme të kërcirit të majtë. Frikë primare me intensitet posaçërisht të lartë 5 sekonda-që përfshinë periudhën nga momenti i perceptimit të rrezikut për kafshim nga ana e qenit deri te kafshimi në këmbën e djathtë dhe vlerësimin e gjendjes së shëndetit fizik. Kjo frikë me intensitet dhe kohëzgjatje është rezultat i drejtpërdrejtë i rrezikut për humbjen e jetës. Frikë sekondare me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej 60 minuta, që përputhet me kohën e nevojshme për transportimin dhe dhënien e ndihmës se parë në qendrën më të afërt shëndetësore, në këtë rast ambulancën numër 5- në Lagjen Fidanishte të Pejës. Kjo frikë ka qenë pasojë e shqetësimeve për te dhimbjeve intensive në këmbë të djathtë, gjakosjes nga këmba si dhe perceptisionit lidhur me shëmtimin e mundshëm trupor. Frikë sekondare me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 2 javësh, gjatë kësaj kohe paditësja ka vazhduar të marr ndihmën e nevojshme që ambulancë ku i është pastru dhe i është fashu e njëjta. Po ashtu sipas deklaratës i është dhënë terapia mbrojtëse prej kafshimit të qenit, terapi tjetër kundër dhimbjeve dhe infeksionit. Gjithë këto procedura të përmendura kanë pas për pasojë paraqitjen e frikës se lartshënuar. Frikë sekondare me intensitet të ultë në kohëzgjatje prej një viti, kjo frikë ka vazhduar të jetë prezentë në varësi nga dhimbjet të cilat kanë qenë rezultat i pozitive të caktuara trupore apo ngarkesave fizike. Në shkresat e lëndës dhe në anamnezë nuk kemi dëshmi që gjatë kësaj periudhe kohore paditësja ka marr trajtim psikiatri, si pasojë e frikës se lartshënuar. Shëmtim turpor ka të shkallës se ulur për shkak të vrazës se mbetur pas kafshimit të qenit në pjesën e pasme të kërcirit të majtë me gjatësi 1.5x0.5cm. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 7 ditësh, sa e ka pasur të lidhur kërcirin e majtë dhe atë ndihmë në veshmbathje dhe mbajtje të higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Ushqimi i përforcuar 7 ditë, i pasur me proteina, minerale, vitamina për përmirësim të gjendjes pas lëndimit. Rehabilitimi fiziko-terapeutik nuk ka qenë i nevojshëm. Paditësi Xhemajl Mustafaj, si pasojë e kafshimit nga qeni me dt. 11.10.2019, ka pësuar këto lëndime trupore: plagë në regjionin e pasëm të kërcirit të djathtë, lëndimet karakterizohen si lëndime të lehta trupore,

dhembjet fizike: - me intensitet posaçërisht të 5 minuta, duke përfshirë kohën nga kafshimi i qenit e deri në marrjen e ndihmës së parë në QKMF Pejë. - Me intensitet të rëndë 12 orë, kohë pas kohe deri në veprimin e terapisë së ordinuar kundër dhimbjes për shkak të dhimbjes në pjesën e pasme të kërcirit të djathtë si pasojë e plagës nga kafshimi i qenit.- Me intensitet të mesëm 4 ditë, koha e nevojshme për tërheqjen e hematomeve, inflamacioneve post traumatike nën veprimin e terapisë, si dhe koha e nevojshme për mbylljen e plagës. -Me Intensitet të ulët intenzivisht edhe për 15 ditë tjera të shprehur me dhimbje të përhershme në pjesën e pasme të kërcirit të majtë. Frikë primare me intensitet posaçërisht të lartë 5 sekonda-që përfshinë periudhën nga momenti i perceptimit të rrezikut për kafshim nga ana e qenit deri te kafshimi në këmbën e djathtë dhe vlerësimin e gjendjes së shëndetit fizik. Kjo frikë me intensitet dhe kohëzgjatje është rezultat i drejtpërdrejtë i rrezikut për humbjen e jetës. Frikë sekondare me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej 60 minuta, që përputhet me kohën e nevojshme për transportimin dhe dhënien e ndihmës së parë në qendrën më të afërt shëndetësore, në këtë rast ambulancën numër 5- në Lagjen Fidanishte të Pejës. Kjo frikë ka qenë pasojë e shqetësimeve për te dhimbjeve intensive në këmbë të djathtë, gjakosjes nga këmba si dhe perceptacionit lidhur me shëmtimin e mundshëm trupor. Frikë sekondare me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 2 javësh, gjatë kësaj kohe paditësja ka vazhduar të marr ndihmën e nevojshme që ambulancë ku i është pastru dhe i është fashu e njëjta. Po ashtu sipas deklaratës i është dhënë terapia mbrojtëse prej kafshimit të qenit, terapi tjetër kundër dhimbjeve dhe infeksionit. Gjithë këto procedura të përmendura kanë pas për pasojë paraqitjen e frikës së lartshënuar. Shëmtim turpor nuk ka. Zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 7 ditësh, sa e ka pasur të lidhur kërcirin e majtë dhe atë ndihmë në veshmbathje dhe mbajtje të higjienës personale dhe kryerjen e aktiviteteve të përditshme jetësore. Ushqimi i përforcuar 7 ditë, i pasur me proteina, minerale, vitamina për përmirësim të gjendjes pas lëndimit. Rehabilitimi fiziko-terapeutik nuk ka qenë i nevojshëm. Kësaj ekspertize gjykata i ka falur besimin në tërësi pasi që e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale nga ekspertët dhe me të cilën është vërtetuar lartësia e kontestit.

Gjykata fillimisht thekson se lidhur me legjitimitetin pasiv të palës së paditur në këtë çështje, në rastet kur të përfshirë janë qentë endacak, pra kur pretendohet që dëmi ka ardhur si rezultat i qenve endacak, e njëjta ka legjitimitet pasiv në procedurë, sepse sipas nenit 17 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale i cili ka papërcaktuar se *“Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzivë, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë”* ndërsa par.1 pika e) *“mbrojtjen e mjedisit lokal”* dhe pika i) *“promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut”* andaj në bazë të kësaj dispozite e paditura Komuna e Pejës ka legjitimitet pasiv.

Sa i përket çështjes së përgjegjësisë së dëmit me këtë rast, me nenin 154 të LMD-së ku është përcaktuar se *“Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i demit”*.

Sipas nenit 7 të LPK-së *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet”* e tilla lidhur

me nenin 319.1 të LPK-së “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.” Palët paditëse me këtë rast, kanë dështuar që të provojnë faktin qenësor në këtë rast se dëmi i cili i ka ndodhur palës paditëse, ka ardhur si rezultat i kafshimit të qenit endacak. Ndonëse rezulton të jetë i provuar fakti se paditësit janë kafshuar nga qeni, i cili fakt u provua me raportet mjekësore të administruara si prova, kurse lartësia e dëmit është provuar përmes ekspertizave mjekësore, në këtë rast ajo e ortopedisë dhe psikiatrisë, por nuk u provua baza e kërkesëpadisë.

Në rastin konkret, pala paditëse nuk ka provuar në mënyrë të sigurve se është kafshuar nga qentë endacak. Në deklarin e tyre në padi, kanë theksuar se janë kafshuar nga qeni endacak ku më pas janë trajtuar në Qendrën e Mjekësisë Familjare V. Për qëllim të vërtetimit të këtij fakti, pala paditëse nuk ka ofruar ndonjë provë ku do të vërtetohet ky fakt crucial në këtë çështje.

Gjykata thekson se, nga ajo që është provuar në procedurë, palës së paditur nuk mund ti mvshet përgjegjësia për kompensim të dëmit në këtë rast, sepse nga provat nuk mund të vërtetohet në mënyrë të pa kontestuar që kafshimi i paditësve ka ardhur nga qentë endacak. Ngase për ti argumentuar thëniet nga padia, pala paditëse nuk ka ofruar asnjë provë qoftë materiale apo ndonjë dëshmitar i cili do të provonte se sulmi ka ndodhur nga qentë endacak. Mënyra se si pala paditëse i provon faktet e pretenduara, është barrë ekskluzive e tij. Për më tepër, gjykata në bazë të provave të cilat janë marrë, nuk ka mundur që në mënyrë të pakontestueshme të provojë këtë fakt qenësor në procedurë, andaj ka vepruar në atë mënyrë që për provimin e këtij fakti, të aplikohen rregullat mbi barrën e provës, sepse mbështetur në nenin 322.2 të LPK-së parashihet që “Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Në një gjendje të tillë, gjykata thekson se qentë të cilët e kanë kafshuar palën paditëse, shumë lehtë kanë mundur të jenë qenë të cilët kanë pasur pronar, ku në bazë të nenit 163 të LMD-së, përgjegjës do të mund të mbahej pronari i qenit.

Në kuptim të nenit 154 të LMD-së, pala e paditur do të mund të mbahej përgjegjëse për rastin e ndodhur, vetëm sikur të ishte provuar që qeni i cili i ka kafshuar paditësit, ishte qen endacak, përndryshe, gjykata vendimin e saj nuk mundet që ta mbështet vetëm në thënie të palës paditëse, por që pretendimet lidhur me faktet e caktuara duhet të mbështeten në prova, qofshin ato materiale apo edhe personale.

Pretendimet tjera të palës paditëse, gjykata i ka marrë në konsideratë, mirëpo të njëjtat nuk kanë luajtur rol për një vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse përcaktuese në këtë rast ishte të provohet nëse qeni i cili i ka kafshuar paditësit, ishte apo jo qen endacak.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në kuptim të nenit 452, 463.1 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë pasi paditësin i kanë kërkuar shpenzimet dhe i ka specifikuar mirëpo të njëjtit e kanë humbur kontestin, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 154 të LMD-së, lidhur me nenin 143 dhe 452.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2019:295531-C.nr. 1603/19, 20.11.2023**

**G j y q t a r i**  
Besnik Shala

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.